

Home ▸ KRONIKË ▸ Posedonte armë zjarri pa leje, arrestohet 42-vjeçari në Pogradec

Posedonte armë zjarri pa leje, arrestohet 42-vjeçari në Pogradec

14:36 - 28 Janar, 2022



Një 42-vjeçar është arrestuar nga policia e Pogradecit pasi në banesën e tij posedonte armë zjarri.

Sipas policisë në pranga ka rënë shtetasi me inicialet H.K., 42-vjeç të cilit iu sekuestruan një armë zjarri automatik, tre karikatorë automatiku, një kapsollë detonatore dhe municion luftarak pa leje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, për veprime të mëtejshme.

Njoftimi i plotë i policisë:

Goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje.

Posedonte armë zjarri në banesën e tij, vihet në pranga 1 shtetas.

Sekuestrohet një armë zjarri automatik, tre karikatorë automatiku, një kapsollë detonatore dhe municion luftarak pa leje.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Pogradec, në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje, kontrolleve të shtuara për rritjen e parametrave të sigurisë, si edhe në bazë të informacioneve të siguruar në rrugë policore se një shtetas posedonte armë zjarri pa leje, organizuan shërbimet, lokalizuan personin dhe ushtruan kontroll në banesën e tij, në fshatin Buzaishtë, Pogradec, ku gjetën e sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri automatik, tre krehëra fishekësh, një kapsollë detonatore dhe një sasi municioni luftarak, të cilat i posedonte pa leje.

Në përfundim të veprimeve, specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Pogradec, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit H. K., 42 vjeç, banues në Buzaishtë.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, për veprime të mëtejshme./Apel.media



Previous article

Shifra të larta/ Rreth 40 mijë raste të reja me COVID-19 në Zvicër

Next article

Alimehmeti: Rreth 95% e rasteve me COVID në vendin tonë janë të variantit Omicron

RELATED ARTICLES

MORE FROM AUTHOR

Durrës/ Përfshihet nga flakët një makinë, s'ka të lënduar

Policia në një javë/ Kontrolle blic, operacione policore, reagim në kohë dhe bashkëpunim me qytetarët


Kanosën dhe rrahën dy persona, arrestohen 3 autorët në Berat



In memoriam/ 91-vjetori i ndarjes nga jeta të atdhetarit të shquar...

23:00 - 6 Shkurt, 2022

Mihal Grameno është një ndër figurat e atdhetarizmit shqiptar, publicist,...



Sytë e botës në Marok/ Si ra 5-vjeçari në pusin 32...

22:48 - 6 Shkurt, 2022



Koreja e Jugut tejkalon 1 milion raste me COVID si rekord...

22:36 - 6 Shkurt, 2022

Dr. Erion Dasho: Koha për një qasje të re ndaj pandemisë...

22:24 - 6 Shkurt, 2022

Akademia Shqiptare e Arteve dhe Shkencave – zë shkencor në mjedisin...

22:12 - 6 Shkurt, 2022

Pedagogia shqiptare në Suedi/ Kemi shumë nevojë që Suedia të njohë...

22:00 - 6 Shkurt, 2022

Amoraliteti përvetësimit të markës 'PARTI DEMOKRATIKE'

21:48 - 6 Shkurt, 2022

Gazetari vlonjat ekspozon Ferid Pashë Vlorën, Kryeministri fundit i Perandorisë Osmane

21:36 - 6 Shkurt, 2022

Përparim Kabo/ Çfarë na mëson teatri?

21:24 - 6 Shkurt, 2022

Paulin Marku: Mosmirënjohësi Basha, i vetëm përballë të gjithëve!

21:14 - 6 Shkurt, 2022

APEL MEDIA është një media digjitale, e cila mund të aksesohet në versionin online në të gjitha rrjetet sociale dhe Appstore, sikurse edhe në versionin print.

+355 69 405 4321

CONTACT@APEL.MEDIA

TIRANE, ALBANIA

Të gjitha të drejtat e rezervuara.
NIPT: L92315010A